



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

Numri i lëndës: 2024:266528

Datë: 26.02.2025

Numri i dokumentit: 06905458

P.nr.273/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA VUSHTRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Besart Prishtina, në çështjen penale kundër të pandehurit F.A. me adresë në Vushtri, dhe të pandehurit L.A. me adresë në Vushtri, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm, PP.II.nr.558/24, të datës 26.09.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të datës 20.02.2025, në praninë e Prokurorit të shtetit Shaqir Sedolli, të pandehurit F.A., të pandehurit L.A., pas shpalljes së aktgjykimit me datë 20.02.2025, me datë 26.02.2025, nxjerr, këtë:

A K T G J Y K I M

TË PANDEHURIT:

1. F.A., nga i ati B..., e ëma Z..., e vajzërisë K..., data e lindjes..., në Vushtri, ku edhe jeton, në rrugën "...", me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer klasën e 7 të shkollës fillore, edhe më parë i gjykuar për vepra të natyrës së njëjtë.

2. L.A., nga i ati A..., nëna F..., e gjinisë H..., data e lindjes..., në Vushtri, ku edhe jeton, në rrugën "...", me numër personal ..., shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i papaunë, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme edhe më parë i gjykuar për vepra penale të natyrës së njëjtë dhe është në vuajtje të dënimit..

JANË FAJTORE

SEPSE: Me datë 16.03.2024 rreth orës 19:20 min, në rrugën "Burim Muli" në Vushtri, saktësisht në stadiumin e gomës, me dashje dhe pa autorizim kanë poseduar narkotikë, në atë mënyrë që njësia patrullues-Njësiti reagues B pranë Stacionit Policor në Vushtri, gjatë patrullimit pranë të pandehurve ku kishin qenë duke qëndruar dhe atë në largësi rreth pesë (5)metra, gjejnë një pako të cigareve me mbishkrimin "Winston", e që në brendi të saj kishte

qenë e vendosur substanca narkotike e llojit kanabis (marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol me peshë neto prej 5.8 ± 0.0001 gram,

- Me këtë kanë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 31, 38, 39, 40, 42, 46, 47, 48, 69, 70, dhe nenit 315 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të KPRK-së si dhe nenit 19. 270, 364, 449, 452 dhe 462 të KPPK-së, të pandehurit, i

G J Y K O N

I. Të pandehurit të parë F.A., i shqipton DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë (18) muajve, si dhe DËNIM ME GJOBË në shumë prej njëmijë (1,000.00 euro), të cilat dënime do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mundet që t'a paguaj gjobën, gjykata, të njëjtën do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që njëzet (20) Euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim.

II. Të pandehurit të dytë L.A., i shqipton DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë (18) muajve, si dhe DËNIM ME GJOBË në shumë prej njëmijë (1,000.00 euro), të cilat dënime do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mundet që t'a paguaj gjobën, gjykata, të njëjtën do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që njëzet (20) Euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim.

Konfiskohet substanca narkotike kanabis (marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto 5.8 ± 0.0001 gram.

Detyrohen të pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor, secili veç e veç të paguajnë shumën prej njëind euro (100.00 Euro).

Detyrohen të pandehurit që në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, secili veç e veç të paguajnë shumën prej njëzet euro (20 Euro).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.558/24, të datës 26.09.2024, kundër të pandehurit F.A. me adresë në rrugën “...” në Vushtri, dhe të pandehurit L.A. me adresë në rrugën “...” në Vushtri, për shkak të veprës penale

Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata me datën 26.11.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën të pandehurit nuk e kanë pranuar fajësinë, e në të cilën të njëjtit janë udhëzuar për të drejtat e tyre për të paraqitur kundërshtimet e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën 20.02.2025, të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm dhe palët i kanë paraqitur fjalët hyrëse, është bërë administrimi i provave materiale dhe personale dhe palët nuk kanë pasur ndonjë propozim për plotësimin e provave. Të pandehurit janë mbrojtur në heshtje dhe pas kësaj palët i kanë paraqitur fjalët përfundimtare.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor

Prokurori i shtetit në fjalën hyrëse ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor në çështjen penale kundër të pandehurve F.A. dhe L.A. përtej dyshimit të bazuar mirë do të vërtetohet se të pandehurit secili veç e veç kanë kryer veprën penale e cila iu vihet në barre si në aktakuzë, ashtu që gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, do të dëgjohet dëshmitarët A.U., U.U. si dhe B.B.. Gjithashtu nga vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të sekuestruara të dt 16.03.2024, do të vërtetohet fakti se është sekuestruar sasia prej 5.8 gr të sub narkotike. Nga foto albumi që gjenden në shkresë të lëndës shihet pakoja e cigares si dhe sub narkotike e mbështjella me qese të tejdukshme. Nga raporti i akt ekspertimit të AKF-së, do të vërtetohet se substanca narkotike përmban kanabis(marihuanë) e cila ka përmbajtje të THC, me peshe të përgjithshme 5.8 gr. Po ashtu nga ekstrakti mbi dënimet penale i cili gjendet në shkresat e lëndës në emër të dy të pandehurve F.A. dhe L.A. rezulton se të dytë janë të gjykuar edhe më parë për vepra penale të njëjta dhe të natyrave tjera.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar pas administrimit të provave materiale dhe personale gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, ku dëshmitarët A.U., U.U. dhe B.B. dëshmuar për mënyrën se si kanë ardhur tek identifikimi i të pandehurve si dhe sekuestrimi i substancë narkotike, nga dëshmitë e të cilëve u vërtetua se të pandehurit pasi që e kanë parë automjetin e policisë kanë hedhur substancë narkotike 5m larg vendit ku kanë qëndruar dhe janë nisur në drejtim tyre, duke u munduar të humbin gjurmët e substancë narkotike, të cilën e kanë pasur me vete. Po ashtu nga dëshmitë e dëshmitarëve u vërtetua edhe fakti se gjatë kohës sa kanë qenë në S.P. Vushtrri në dhomën e pritjes, i pandehuri L.A. paraprakisht ka deklaruar se substancë narkotike është e tyre. Po ashtu nga vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve vërtetohet sasia e narkotikeve të sekuestruar si dhe nga fotoalbumi shihet pakoja e cigares Winston e cila pako është e freskët, e pa dëmtuar, ku në të shihet substancë narkotike e mbështjellë me qese të tejdukshme, dhe pas raportit të AKF-së, ka rezultuar se njëjta përmban THC- mardhanë me peshe të përgjithshme prej 5.8 gram andaj nga gjithë këto prova të administruara është vërtetuar se të pandehurit janë fajtor për veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, andaj gjykatës i propozoj që të pandehurit të i shpall fajtor dhe të i dënoj sipas ligjit ndërsa me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë të dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Si rrethanë rënduese të merr

parasysh faktin se këto vepra penale me narkotikë paraqesin një rrezikshmëri të lartë për shoqërinë, e po ashtu te merr parasysh te kaluarën kriminale të pandehurve, ku nga ekstraktet e administruara mbi dënimet penale te dy te pandehurve rezulton se te njëjtit kane edhe dënime të tjera te dënuara me aktgjykime te formës së prerë.

I pandehuri i parë F.A. në fjalën hyrëse ka deklaruar se narkotiket nuk kane qenë në posedim timin dhe se nuk e ndjej veten fajtor për këtë vepër, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë dhe se nuk ndjehet fajtor për veprën.

I pandehuri i dytë L.A. në fjalën hyrëse ka deklaruar se narkotiket nuk kane qenë në posedim timin dhe se nuk e ndjej veten fajtor për këtë vepër, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë dhe se nuk ndjehet fajtor për veprën.

Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor

Gjykata me rastin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit në pajtim me ligjin, më vëmendje të plotë dhe me përkushtim profesional dhe me përkujdesje vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe faktet në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të tij, në vazhdim janë të shtjelluara provat e administruara, përfshirë:

Provat personale

- Në cilësinë e dëshmitarit, në seancën e datës 20.02.2025, është dëgjuar A.U., zyrtar policor i cili ka deklaruar se atë ditë kemi qenë tek stadiumi i gomës rr.”Burim Muli”, dhe kemi hasur në dy persona F.A.n dhe L.A.n me nofka të ndryshme “Pitbull” dhe “Flamur shpejtësia “ në momentin që e kanë vërejtur veturën e policisë, të njëjtit kanë qenë të ulur në shkallë të betonit, dhe posa na kanë vërejtur- veturën e policisë janë ngritur në këmbë dhe kanë ardhur ne drejtim tonin, pa i kërkuar nga ata që të vinin, pastaj ne i kemi pyetur se a keni diçka me vete të kundërligjshme, të njëjtit na kanë thënë që nuk kishin. Pasi kemi kontrolluar vendin ku ata kanë qëndruar në fillim, ka qenë një pako cigare Winston dhe kur e kemi hapur të njëjtën kemi vërejtur se brenda saj gjendet substanca narkotike dhe distanca prej vendit ku kane qenë të ulur këta ka qenë jo me larg se 5 metra. Tutje ka shtuar se nuk i kanë parë të kenë gjuajtur diçka, nuk kanë nuhatur aromë të substancave narkotike si dhe në atë lokacion në atë kohë nuk ka pasur persona tjera, përpos të pandehurve, ndërsa pakoja me substanca narkotike ka qenë e freskët . Në fund ka shtuar se gjatë shoqërimit për në stacionin e policisë i pandehuri i dytë L.A. ka pranuar se substanca narkotike ka qenë e tyre.

- Në cilësinë e dëshmitarit, në seancën e datës 20.02.2025, është dëgjuar U.U., zyrtar policor i cili ka deklaruar se për rastin kemi përpiluar raport ashtu siç raportojmë për secilin rast, i njëjti raport me kujtohet por jo edhe data e saktë. E di që kemi qenë në ndërrim të natës 12h duke punuar, njësia jonë e përbërë nga 3 zyrtar policor, në momentin që e marrim ndërrimin patrollojmë në rrugët ose vendet ku frekuentohet nga personat që përdorin narkotikë. Në vendin

i cili quhet stadium i gomës ose rr. “Burim Muli”, aty i kemi parë këta dy persona të cilët janë të njohur për policinë si për vepra penale të vjedhjes si dhe të narkotikeve, pasi që kam punuar edhe si hetues dhe jam në njohuri që këta kanë shumë raste, dhe pothuajse në shumicën e rasteve sa i përket narkotikeve e posaçërisht Flamuri në mënyrë të vazhdueshme heshtë dhe nuk deklarohet. Në momentin që i kemi parë këta dy persona, i kemi legjitimuar, kanë qenë të ulur në shkallë dhe posa na kanë vërejtur neve të njëjtit janë ngritur në këmbë dhe kanë lëvizur. Pasi që jemi ne dijeni se te njëjti janë përdorues të substancave i kemi bërë kontrollim në trupin e tyre dhe nuk kemi gjetur asgjë. Pas kontrollimit të trupit ne bëjmë edhe kontrollimin e vendit në një perimetër të afërt, dhe me sa më kujtohet në një distancë prej 5 metra nga vendi ku kanë qenë të ulur dy të pandehurit kemi hasur në një pako cigare Winston, dhe pas hapjes nga kolegu im A.U. kemi vërejtur se aty ka substancë të dyshuar narkotike, dhe ne aty kemi dyshuar se kjo substancë narkotike është e dy të pandehurve. Më pas i kemi shoqëruar në Stacionin Policor dhe kemi komunikuar me njësinë e hetimeve. Tutje kas shtuar se pa s sjelljes në stacion, në sallën e pritjes ku e bëjnë sigurimin e tyre derisa në kohën kur njësia e hetimeve vijë për t’i intervistuar, në ato momente L.A. ka deklaruar se substanca narkotike ka qenë e tyre. Në fund ka shtuar se në momentin kur kanë hasur në dy të pandehurit në vendin e sipër cekur, ka qenë natë, rreth orës 19:30 dhe se në atë lokacion nuk ka qenë askush tjetër, ndërsa pakoja me substanca narkotike që e kanë gjetur aty ka qenë e freskët.

- Në cilësinë e dëshmitarit, në seancën e datës 20.02.2025, është dëgjuar B.B., zyrtar policor i cili ka deklaruar se kemi qenë në patrullë në stadiumin e gomës në rr. “Burim Muli”, pasi që ai vend është i njohur për frekuentimin e personave që konsumojnë narkotikë, ne me veturën zyrtare të policisë kemi hyrë brenda në fushë, kane qenë F... dhe L... duke qëndruar ulur në shkallët e betonit. Në momentin që e kane parë veturën e policisë, me sa më kujtohet të njëjtit pa i thirrur fare ne janë afruar në drejtim të veturës sonë, dhe për arsye se ne i njohim që të dy fillimisht i kemi pyetur se a kane ndonjë send ilegal me vete, dhe te njëjtit janë deklaruar se jo nuk kanë. Pas kontrollimit të vendit ku kanë qëndruar të njëjtit ne kemi gjetur një pako me cigare Winston, diku 5-6 metra nga vendi ku kanë qëndruar ulur dy të pandehurit, dhe me pas ne i kemi shoqëruar për në Stacionin Policor në Vushtrri. Gojarisht L.A. e ka pranuar në Stacionin Policor në Vushtrri se substanca me narkotik ka qenë e tyre dhe për këtë i kemi njoftuar njësinë e hetimeve. Në fund ka shtuar se në stadium në atë kohë nuk ka qenë askush tjetër dhe se pakoja me substancë narkotike ka qenë e freskët.

Provat materiale

- Raporti fillestar i incidentit i datës 16.03.2024 në të cilin përshkruhet vendi dhe koha e incidentit, pra data 16.03.2024, ora 19:20, rruga “Burim Muli”, vepra penale e cila dyshohet se është kryer si dhe personat e dyshuar për veprën penale.

- Raporti i oficerit i datës 16.03.2024, në të cilin përshkruhet se si me datën 16.03.2024, rreth orës 19:20 gjatë patrullimit në rrugën “Burim Muli” (në stadiumin e gomës) janë hasur dy persona të cilit kishin qenë duke qëndruar aty dhe atë L.A. dhe F.A., të cilit ishin të njohur për policinë si përdorues të substancave narkotike. Ashtu që, menjëherë kanë bërë legjitimimin e tyre dhe një kontroll të detajuar, ku në një perimetër prej rreth 5 metra është hasur një pako e cigare

“Winston” e cila kishte qenë e mbushur me substancë të dyshuar narkotike. Poashtu theksohet se të dyshuarit janë shoqëruar në Stacionin e Policisë në Vushtri, ndërsa është konfiskuar substanca e dyshuar narkotike, ku njësia e hetimeve kanë bërë matjen e substancës së dyshuar e cila ka rezultuar me 6.5gram.

- Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht i datës 16.03.2024, për të dy të pandehurit, në të cilin përshkruhet substanca e dyshuar narkotike (marihuanë) me peshë prej 6.5gram, e cila është konfiskuar nga Policia e Kosovës.

- Procesverbali marrjes në pyetje i të pandehurit F.A. i datës 16.03.2024, në të cilin i njëjti ka deklaruar se derisa ka qenë së bashku me shokun e tij L.A., në rrugën “Burim Muli”, në stadiumin e gomës në Vushtri, papritmas kanë ardhur disa polic me një veturë dhe kanë kontaktuar me të njëjtit, duke i pyetur se a kanë ndonjë send ilegal me veti, ku i njëjti ka deklaruar se nuk kanë, ndërsa policia ju ka thënë se duhet t’ua bëjnë një kontroll dhe pasi i kanë kontrolluar dhe nuk kanë gjetur asgjë, të njëjtit (pra policia) ka filluar të kontrollojë stadiumin dhe disa metra më lartë ku kanë qenë të pandehurit, policia ka gjetur një pako me cigare dhe pastaj i kanë sjellë në Stacionin Policor në Vushtri për të dhënë deklarata, dhe pastaj kanë kuptuar se në pakon e cigare kishte pasur substancë narkotike. Tutje ka shtuar se i njëjti punon me hekura, nuk konsumon substanca narkotike, ndërsa duhanin e konsumon që 15 vite dhe se pakoja e cigareve me mbishkrimin “Winston” është gjetur 5-6 metra nga vendi ku kanë qenë të njëjtit duke qëndruar. Në fund ka shtuar se gjatë kohës sa kanë qenë të njëjtit në atë lokacion, nuk e ka parë askënd tjetër.

- Procesverbali marrjes në pyetje i të pandehurit L.A. i datës 16.03.2024, në të cilin i njëjti ka deklaruar se me datën 16.03.2024, rreth orës 18:30 ka dal në qytet, është takuar me shokun e tij F.A.n dhe së bashku kanë shëtitur nëpër qytet, kanë marrë nga një pije dhe kanë shkuar në stadiumin e gomës në Vushtri për të pirë lëngje dhe për të ndenjur e folur dhe derisa ishin aty, ka kaluar një patrullë e policisë, është ndalë vetura, dhe nga vetura kanë dal tre polic të cilët kanë lëvizur në drejtim të të pandehurve ku i kanë pyetur “a keni diçka ilegale me veti”, dhe i pandehuri i’u ka thënë se nuk kemi asgjë, as unë e as shoku im, dhe pastaj policia kanë filluar kontrollin në trup dhe te asnjëri prej neve nuk kanë gjetur asgjë dhe pastaj kanë filluar duke kontrolluar hapësirën afër, ku në distancë prej 5 metrave nga vendi ku kemi qenë ne, kanë gjetur një pako të cigareve me substancë narkotike dhe pastaj i kanë pyetur se u kujt është kjo, ndërsa të pandehurit janë përgjigjur se nuk është e tyre, ashtu që të njëjtit janë shoqëruar në Stacionin e Policisë në Vushtri për intervistim. Tutje ka deklaruar se rrallë herë përdor narkotik, por që nuk e shet, se i njëjti ka edhe raste tjera në polici për narkotik, ndërsa ka deklaruar se kur kanë shkuar në stadiumin e gomës kanë qenë edhe 3-4 persona të cilat 3-4 minuta para arritjes së policisë janë larguar.

- Raporti i ekspertimit AKF-2024-2376/24-2265, i datës .12.08.2024 në të cilin është konstatuar se sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike dëshmia me shifër D#1.a përmban Kanabis (marihuanë), që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë neto të përgjithshme e përafërt 5.8 ± 0.0001 gram.

- Foto dokumentacioni dhe atë foto nr.1, ku shihet pakoja e cigareve si dhe foto nr.2 ku shihet peshorja e matjes së narkotikëve dhe narkotikët.

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet

Faktet jokontestuese

- Është fakt jo kontestues se me datë 16.03.2024 në stadiumin e gomës në Vushtrri janë hasur të pandehurit F.A. dhe L.A.;
- Është fakt jokontestues se në po të njëjtin lokacion, në distancë prej rreth 5 metrave nga vendi ku kanë qëndruar të pandehurit policia ka gjetur në pako të cigareve me mbishkrimin “Winston”, e mbushur me substancë të dyshuar narkotike.

Këto fakte nuk janë kontestuar nga palët, përkundrazi janë pohuar dhe përveç kësaj këto fakte vërtetohen edhe nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor që janë pjesë e kësaj lënde penale.

Faktet kontestuese

- Kontestuese ishte nëse pako e cigareve me mbishkrim “Einston”, e cila kishte rezultuar me jetë me substancë narkotike të llojit marihuanë, kishte qenë e të pandehurve.

Ky fakt është kontestuar nga të pandehurit gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën hyrëse si dhe në fjalën përfundimtare, ashtu që gjykata me qëllim të zgjidhjes së këtij fakti ka administruar provat (personale dhe materiale)

Vlerësimi i provave nga gjykata

Gjykata pas prezantimit të provave, plotësisht dhe përtej dyshimit të bazuar, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

- Nga dëgjimi i dëshmitarit, në seancën e datës 20.02.2025, gjykata ka vërtetuar se atë ditë kanë qenë tek stadiumi i gomës rr. “Burim Muli”, dhe kanë hasur në dy persona F.A.n dhe L.A.n me nofka të ndryshme “Pitbull” dhe “Flamur shpejtësia”, të pandehuri dhe se aty nuk kishte pasur persona tjerë prezent dhe në momentin që e kanë vërejtur veturën e policisë, të njëjtit kanë qenë të ulur në shkallë të betonit, janë ngritur në këmbë dhe kanë lëvizur në drejtim të zyrtarëve policor, pa i kërkuar nga ata që të vinin, pasi kanë bërë kontrollimin vendin ku ata kanë qëndruar në fillim, ka qenë një pako e cigareve “Winston” e cila ka qenë e freskët dhe kur e është hapur pakoja kemi vërejtur se brenda saj gjendet substanca narkotike dhe distanca prej vendit ku kane qenë të ulur këta ka qenë jo me larg se 5 metra por që nuk i kanë parë të kenë gjuajtur diçka ndërsa gjatë shoqërimit për në stacionin e policisë, në brendi, pandehuri i dytë L.A. ka pranuar se substanca narkotike ka qenë e tyre.

- Nga dëgjimi e dëshmitarit U.U. e dhënë në seancën e datës 20.02.2025, gjykata ka vërtetuar se i njëjti me dy kolegët e tij ka qenë në ndërrim të natës 12h duke punuar, njësia e tyre e përbërë nga 3 zyrtar policor, në momentin që e kanë marrim ndërrimin kanë filluar patrullimin e rrugëve ose vendeve që frekuentohen nga personat që përdorin narkotikë. Në vendin i cili quhet stadium i gomës ose rr.”Burim Muli”, aty i kanë parë këta dy persona të cilët ishin të njohur për policinë si për vepra penale te vjedhjes si dhe te narkotikeve, ndërsa aty nuk kishte persona tjerë, në momentin që i kanë parë këta dy persona, kanë qenë të ulur në shkallë dhe posa i kanë vërejtur zyrtarët policor të njëjtit janë ngritur në këmbë dhe kanë lëvizur. Pasi që kanë qenë në dijeni se të njëjtit janë përdorues të substancave i kanë kontrolluar në trupin e tyre dhe nuk kanë gjetur asgjë. Pas kontrollimit të trupit kanë bërë edhe kontrollimin e vendit në një perimetër të afërt, dhe në një distancë prej 5m nga vendi ku kanë qenë të ulur dy te pandehurit kanë hasur në një pako të cigareve Winston, e cila pako ishte e freskët dhe pas hapjes nga zyrtari policor A.U. kanë vërejtur se aty kishte substancë të dyshuar narkotike, dhe ne aty kemi dyshuar se kjo substancë narkotike është e dy te pandehurve. Më pas të njëjtit janë shoqëruar në Stacionin Policor dhe ku janë njoftuar njësitë e hetimeve, ku pas sjelljes në stacion, në sallën e pritjes L.A. ka deklaruar se substanca narkotike ka qenë e tyre.

- Nga dëgjimi i dëshmitarit, B.B. në seancën e datës 20.02.2025 gjykata ka vërtetuar se i njëjti së bashku me dy kolegët e tij ka qenë në patrullë në stadiumin e gomës në rr. “Burim Muli”, pasi që ai vend është i njohur për frekuentimin e personave që konsumojnë narkotikë, ku me veturën zyrtare të policisë kanë hyrë brenda në fushë, ku kane qenë F... dhe L... duke qëndruar ulur në shkallët e betonit dhe përveç tyre në atë kohë nuk ka qenë askush tjetër në stadium. Në momentin që e të njëjtit e kane parë veturën e policisë, të njëjtit pa i thirrur fare ne janë afruar në drejtim te veturës sonë, dhe për arsye se të pandehurit ishin persona të njohur për policinë fillimisht i kanë pyetur se a kane ndonjë send ilegal me vete, dhe te njëjtit janë deklaruar se jo nuk kanë. Pas kontrollimit të vendit ku kanë qëndruar të njëjtit zyrtarët policor kanë gjetur një pako të cigareve Winston, diku 5-6 metra nga vendi ku kanë qëndruar ulur dy të pandehurit e cila pako ishte me substancë narkotike ka qenë e freskët, dhe me pas të njëjtit i kanë shoqëruar për në Stacionin Policor në Vushtrri. Gojarisht L.A. e ka pranuar në Stacionin Policor në Vushtrri se substanca me narkotik ka qenë e tyre dhe për këtë i kemi njoftuar njësinë e hetimeve..

- Nga raporti fillestar i incidentit i datës 16.03.2024, gjykata ka vërtetuar se me datën 16.03.2024, ora 19:20, rruga “Burim Muli”, është kryer vepër penale lidhur me narkotik dhe se vepra është kryer nga të pandehurit, pra F.A. dhe L.A..

- Nga raporti i oficerit i datës 16.03.2024, gjykata ka vërtetuar se me datën 16.03.2024, rreth orës 19:20 gjatë patrullimit në rrugën “Burim Muli” (në stadiumin e gomës) janë hasur dy persona të cilët kishin qenë duke qëndruar aty dhe atë L.A. dhe F.A., të cilët ishin të njohur për policinë si përdorues të substancave narkotike. Ashtu që, menjëherë kanë bërë legjitimimin e tyre dhe një kontroll të detajuar, ku në një perimetër prej rreth 5 metra është hasur një pako e cigare “Winston” e cila kishte qenë e mbushur me substancë të dyshuar narkotike. Po ashtu theksohet se të dyshuarit janë shoqëruar në Stacionin e Policisë në Vushtrri, ndërsa është konfiskuar substanca e dyshuar narkotike, ku njësia e hetimeve kanë bërë matjen e substancës së dyshuar e cila ka rezultuar me 6.5gram.

- Nga vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht i datës 16.03.2024, gjykata ka vërtetuar se nga të pandehurit është sekuestruar përkohësisht nga Policia e Kosovës substanca e dyshuar narkotike (marihuanë) me peshë prej 6.5gram.

- Nga procesverbali marrjes në pyetje i të pandehurit F.A. i datës 16.03.2024, gjykata ka konstatuar se i njëjti ka deklaruar se derisa ka qenë së bashku me shokun e tij L.A., në rrugën “Burim Muli”, në stadiumin e gomës në Vushtrri, papritmas kanë ardhur disa polici me një veturë dhe kanë kontaktuar me të njëjtit, duke i pyetur se a kanë ndonjë send ilegal me veti, ku i njëjti ka deklaruar se nuk kanë, ndërsa policia ju ka thënë se duhet t’ua bëjnë një kontroll dhe pasi i kanë kontrolluar dhe nuk i’u kanë gjetur asgjë, të njëjtit (pra policia) ka filluar ta kontrollojnë stadiumin dhe disa metra më lartë ku kanë qenë të pandehurit, policia ka gjetur një pako me cigare dhe pastaj i kanë sjellë në Stacionin Policor në Vushtrri për të dhënë deklarata, dhe pastaj kanë kuptuar se në pakon e cigare kishte pasur substancë narkotike. Tutje ka shtuar se i njëjti punon me hekura, nuk konsumon substanca narkotike, ndërsa duhanin e konsumon që 15 vite dhe se pakoja e cigareve me mbishkrimin “Winston” është gjetur 5-6 metra nga vendi ku kanë qenë të njëjtit duke qëndruar. Në fund ka shtuar se gjatë kohës sa kanë qenë të njëjtit në atë lokacion, nuk e ka parë askënd tjetër.

- Nga procesverbali marrjes në pyetje i të pandehurit L.A. i datës 16.03.2024, gjykata ka konstatuar se i njëjti ka deklaruar se me datën 16.03.2024, rreth orës 18:30 ka dal në qytet, është takuar me shokun e tij F.A.n dhe së bashku kanë shëtitur nëpër qytet, kanë marrë nga një pije dhe kanë shkuar në stadiumin e gomës në Vushtrri për të pirë lëngje dhe për të ndenjur e folur dhe derisa ishin aty, ka kaluar një patrullë e policisë, është ndalë vetura, dhe nga vetura kanë dal tre polic të cilët kanë lëvizur në drejtim të të pandehurve ku i kanë pyetur “a keni diçka ilegale me veti”, dhe i pandehuri i’u ka thënë se nuk kemi asgjë, as unë e as shoku im, dhe pastaj policia kanë filluar kontrollin në trup dhe te asnjëri prej neve nuk kanë gjetur asgjë dhe pastaj kanë filluar me kontroll në hapësirën afër, ku në distancë prej 5 metrave nga vendi ku kemi qenë ne, kanë gjetur një pako të cigareve me substancë narkotike dhe pastaj i kanë pyetur se u kujt është kjo, ndërsa të pandehurit janë përgjigjur se nuk është e tyre, ashtu që të njëjtit janë shoqëruar në Stacionin e Policisë në Vushtrri për intervistim. Tutje ka deklaruar se rrallë herë përdor narkotik, por që nuk e shet, se i njëjti ka edhe raste tjera në polici për narkotik, ndërsa ka deklaruar se kur kanë shkuar në stadiumin e gomës kanë qenë edhe 3-4 persona të cilat 3-4 minuta para arritjes së policisë janë larguar.

- Nga raporti i ekspertimit AKF-2024-2376/24-2265, i datës 12.08.2024, gjykata ka vërtetuar se substanca e dyshuar narkotike e gjetur në pakon e cigareve me mbishkrimin “Winston” ka rezultuar të jetë Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë neto të përgjithshme e përafërt 5.8 ± 0.0001 gram.

- Foto dokumentacioni dhe atë foto nr.1, ku shihet pakoja e cigareve si dhe foto nr.2 ku shihet peshorja e matjes së narkotikëve dhe narkotikët.

Gjykata, dëshmisë së dëshmitarëve A.U., U.U. dhe B.B., u'a fali besimin në tërësi, pasi që deklaratimet e tyre ishin konsistente, në përputhshmëri me njëra tjetrën si dhe në përputhshmëri edhe me provat tjera në shkresat e lëndës. Që të tre dëshmitarët kanë dëshmuar se në kohën kur i kanë parë të pandehurit në lokacionin e sipër cekur, aty, në atë lokacion në atë kohë nuk ka qenë askush tjetër e që kjo pjesë e dëshmisë së tyre është dhe gjatë asaj kohe, në afërsi prej 5 metrave të është gjetur një pako e cigareve me mbishkrimin "Winston", pako e freskët, me substancë të dyshuar narkotike, më vonë e konfirmuar përmes ekspertizës), Në këtë kontekst të dy të pandehurit kanë pranuar gjatë marrjes në pyetje në polici me datën 16.03.2024, në atë kohë nuk ka qenë askush tjetër në stadium, e po ashtu kanë pranuar se pakoja e cigareve me mbishkrimin "Winston" e cila ishte me substancë narkotike është gjetur rreth 5 metra larg vendit ku kanë qëndruar të njëjtit.

Për gjykatën hasja e të pandehurve në atë lokacion, në të cilin nuk ishte askush tjetër, dhe gjetja e pakos së cigareve me mbishkrimin "Winston" me substancë narkotike 5 metra larg vendit ku po qëndronin të pandehurit, është mjaftueshëm bindëse se pakoja e cigareve në fjalë ka qenë e të pandehurve, kjo për faktin se të pandehurit ishin të vetmit persona prezent në lokacion, dhe fizikisht do të ishte e pamundur që pakoja të ishte e dikujt tjetër apo jetë hedhur nga dikush tjetër kur për më tepër, të tre dëshmitarët kanë deklaruar se pakoja e gjetur ishte e freskët, pra nuk ka qëndruar aty për kohë të gjatë, kjo kur kihet parasysh edhe deklarimi i të pandehurit të dytë në polici se i njëjti përdor substanca narkotike kohë pas kohe, si dhe faktin se që të dy të pandehurit kanë dënime të plotfuqishme nga gjykata pikërisht për vepër të njëjtë penale.

Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, vepra penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 kryhet nga "*Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.*"

Sipas vlerësimit të gjykatës, përmes provave të administruara dhe dëshmitarëve të pyetur është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale e cila i'u vihet në barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë. Pra, gjykata gjatë procedimit gjyqësor ka vërtetuar se të pandehurit kanë poseduar substancave narkotike, dhe atë Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë neto të përgjithshme e përafërt 5.8 ± 0.0001 gram, e cila përmbajtje është vërtetuar nga ekspertimi nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë.

Kjo gjykatë, konsideron se përtej çdo dyshimi të bazuar, është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, si në dispozitiv të aktgjykimit dhe se në veprimet e të pandehurve, manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit me burgim dhe me gjobë gjykata mori parasysh rrethanat lehtësuese si dhe rrethanat rënduese, si rrethane lehtësuese gjykata sa i përket të pandehurit të parë ka marrë faktin se i njëjti ka gjendje jo të mirë ekonomike, ndërsa si rrethana

rënduese, shkallën e përgjegjesisë penale, meqë rast vepra është kryer me dashje të lartë nga ana e të pandehurit të parit të parë, rrezikshmërinë shoqërore të veprës së kryer nga i pandehuri, sidomos duke pasur parasysh se e njëjta është kryer në qendër të qytetit dhe atë në fushë të sportit, si dhe faktin se i njëjti ka qenë edhe më parë i dënuar për vepra penale të kësaj natyre por edhe të natyrave të tjera, dhe atë nga ekstrakti mbi dënimet penale për të pandehurin F.A., sipas shenjës E1/1222/2024/DEPQ/KGJK, ndërsa sa i përket të pandehurit të dytë për të gjykata mori parasysh rrethanat lehtësuese si dhe rrethanat rënduese, si rrethane lehtësuese gjykata sa i përket të pandehurit të dytë ka marrë faktin se i njëjti është i pa punë, ndërsa si rrethana rënduese, shkallën e përgjegjesisë penale, meqë rast vepra është kryer me dashje të lartë nga ana e të pandehurit të parit të parë, rrezikshmërinë shoqërore të veprës së kryer nga i pandehuri, sidomos duke pasur parasysh se e njëjta është kryer në qendër të qytetit dhe atë në fushë të sportit, si dhe faktin se i njëjti ka qenë edhe më parë i dënuar për vepra penale të kësaj natyre por edhe të natyrave të tjera, dhe atë nga ekstrakti mbi dënimet penale për të pandehurin L.A., sipas shenjës E1/1223/2024/DEPQ/KGJK si dhe ekstraktit mbi dënimet penale për të pandehurin.

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim me nenin 38 të Kodit Penal të RKS-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsojë dënimin kundër tij, si dhe me këtë dënim të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe të ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i këtyre dënimeve ndaj të pandehurit është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjesisë të të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur konfiskimin, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin për konfiskimin e Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë neto të përgjithshme e përafërt 5.8 ± 0.0001 gram gjykata e ka marrë konform nenit 269 par.3 të KPRK-së ku është përcaktuar se “*Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen.*”

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 dhe 2.9 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 19, 358, 364, 449, të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA VUSHTERRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.273/24, datë 26.02.2025

Gjyqtari i vetëm gjykues
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.